

**Projekti:** Rimëkëmbje nga Përmbytjet: Bujqësia dhe Zhvillimi Ekonomik

**Vendi i zbatimit:** Fier, Vlorë, Lushnjë, Berat, Gjirokastrë, Korçë

**Emri Aplikantit:** Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

**Kohëzgjatja:** 24 muaj

**Buxheti total:** 7 110 000 EUR

6 400 000 EUR Kontribut I BE-së

710 000 EUR Kontribut I Qeverisë Shqiptare

**Objektivi i Projektit:** Të ndihmojë në rimëkëmbjen pas fatkeqësisë të familjeve bujqësore të prekura nga përmbytjet në vend, në shkurt të vitit 2015, sidomos në 6 rajonet më të dëmtuara.

Projekti ka për qëllim të:

- Të ofrojë kompensim dhe grant investimi në vlerë prej 6.1 milion EUR për rreth 4.053 fermerë dhe familjeve bujqësore, si dhe rreth 200 familje/agrobiznese, në mënyrë që të mbështesë në përmirësimin e qëndrueshëm të jetesën së tyre;
- Të forcojë shërbimin e këshillimit bujqësor /extensionin për nevojat e sektorit të bujqësisë.

**Grupet e synuara:**

- Familjet bujqësore të prekura nga përmbytjet;
- Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, shërbimin këshillimor, (përfshirë qendrat e transferimit të teknologjisë bujqësore), shërbimet e qeverisjes lokale, Universitetin Bujqësor;
- OJQ-të dhe /ose SME të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për fermerët dhe/ose të gatshëm për të investuar për zhvillimin ekonomik lokal.

**Përfituesit final:**

- Rreth 4053 fermerë, familje bujqësore;
- Rreth 200 familje/agrobiznese të prekura nga përmbytjet;
- Sektorët e Shërbimeve në Ministri;
- Shërbimi i ekstensionit bujqësor;
- Universiteti Bujqësor.

## Rezultatet Kryesore:

- **Granti Kompensimit:** rreth 3.4 milion EUR për rreth 4 053 fermërë të prekur;
- **Granti Investimit:** rreth 2.7 Milion EUR për rreth 200 familje fermere/agrobiznese të dëmtura;
- **Asistencë Teknike:**
  - 100 persona të trajnuar në metodologji PDNA staf i Ministrisë së Bujqësisë dhe Drejtorive Rajonale të Bujqësisë, AZHBR, Shërbimi Këshillimor, Universiteti Bujqësor;
  - 750 persona të trajnuar në Climate Smart Agriculture, Conservation Agriculture (CA), dhe Integrated Pest Management (IPM), staf i shërbimit këshillimor, Universitetit Bujqësor, NGO, si dhe organizata prodhuesish;

## Përshkrim i shkurtër:

Shqipëria nga 1 deri në 5 shkurt 2015 u godit nga rreshje që shkuan deri në 200 mm në vetëm tre ditë. Rajonet më të prekur ishin në juglindje të Shqipërisë dhe zonat jugore. Rreth 10,000 ha të tokës bujqësore u dëmtuan në rajonet e Vlorës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Korçës dhe Gjirokastrës. Shumica e dëmeve ishin në bujqësi ku u dëmtuan një sërë kulturash bujqësore, bimë foragjere, u dëmtuan serra të prodhimit të hershëm të perimeve dhe frutave (luleshtrydhe), si dhe pemishte. Nën-sektori i blegtorisë u dëmtua në një masë më të vogël, edhe pse mungesa e ushqimit në muajt e ardhshëm do të ndikonte negativisht në prodhimet shtazore.

BE-ja, OKB-ja dhe BB me kërkesë të Qeverisë Shqiptare kontribuan në vlerësimin e nevojave post-fatkeqësi. Bazuar në këtë vlerësim, BE-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, hartuan një program të rimëkëmbjes nga përmbytjet që shkonte përtej restaurimit të thjeshtë të para-vërshimeve dhe synonte rritjen e rezistencës në aspektin e infrastrukturës, institucionale dhe implikimeve sociale.

Si rezultat, u identifikuan tre komponente për një shumë të përgjithshme prej 14.9 milion Euro:

**Komponenti 1:** Përforcimi i infrastrukturës dhe kontrollin e përmbytjeve - 6 milion Euro, zbatuar nga UNDP;

**Komponenti 2:** Përmirësimi për përgatitjen e mbrojtjes civile dhe uljen e rrezikut të fatkeqësive - 2.5 milion Euro, zbatuar nga Ministria e Brendshme;

**Komponenti 3:** Rivendosja e dëmeve bujqësore dhe rivendosja e kapaciteteve prodhuese - 6,4 milion Euro, zbatuar nga Ministria e Bujqësisë.

Për zbatimin e Komponentit të 3, Ministria e Bujqësisë, nënshkroi dy marrëveshje bashkëpunimi, një me FAO për Asistencë Teknike, për të ndihmuar në rindërtimin e kushteve të jetesës dhe për të rritur aftësinë e reagimit ndaj fatkeqësive të tilla në komunitetet rurale; si dhe një tjetër me AZHBR për zbatimin e projektit.

#### **Procedurat e ndjekura:**

1. Nënshkrimi i marrëveshjeve respektive me FAO dhe AZHBR;
2. Përpunimi i listave të fermerëve të dëmtuar, hartuar dhe dërguar nga prefekturat përkatëse;
3. Hartimi i një metodologjie dhe Manuali Procedurash, me asistencë të FAO-s;
4. Njoftimi i personave të prekur, përmes dëgimit dhe shpalljes së listave pranë Prefekturave dhe Drejtorive Rajonale të Bujqësisë;
5. Kompensimi i fermerëve;
6. Hartimi i një udhëzuesi për aplikantët për thirrjen për grantin e investimeve.

#### **Arritjet e projektit:**

1. Nën komponentin e Grantit të Kompensimit, deri në datë 30 qershor 2016 janë kompensuar 3 067 fermerë me rreth 369 milion lek ose 2.6 milion EUR, në 5 Rajone (Vlorë, Fier, Gjirokastër, Berat dhe Korçë).

Disbursimet sipas rretheve janë si më poshtë:

<b>Rajonet</b>	<b>Nr. perfituesve</b>
Berat	356
Fier	733
Gjirokaster	82
Korce	1318
Vlore	578
TOTALI	3,067

*Burimi: AZHBR, raporti përfundimtar*

Deri më datën 9 Shtator, priten dhe ankesat e fermerëve sipas një procedure të qartë të hartuar nga Ministria e Bujqësisë në bashkëpunim me FAO-n, përcjellë për zbatim në Prefekturat dhe Drejtoritë e Bujqësisë përkatëse;

2. Është në fazën e aprovimit dhe Udhëzuesi për Aplikantët për Grantin e Investimeve i cili do të hapet përmes një thirrje publike nga AZHBR. Ky udhëzues është përgatitur nga një grup ekspertësh të fushës me asistencë të projektit SARD-GIZ;
3. Është hartuar projekti i Vizibilitetit;
4. Është hartuar plani i monitorimit të projektit;
5. Janë angazhuar ekspertët kombëtar dhe ndërkombëtar që do të kryejnë trainimet sipas një plani të përcaktuar.

#### **Problematika të hasura:**

1. Hera e parë e zbatimit të një projekti të tillë Grant Direkt për fermerët;
2. Mungesa e një metodologjie të caktuar që në fillim në momentin e përmbytjes;
3. Gabime në emrat dhe mbiemrat e përfituesve;
4. Mungesa e numrave të llogarive të fermerëve;
5. Vonesa në hapjen e tyre;
6. Vonesa në procesin e verifikimit nga bankat, etj.